



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 233

Tiranë – E hënë, 15 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 705, datë 9.12.2025	Për delegim kompetence.....	28923
Vendim i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 35, datë 11.12.2025	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 13.3.2019, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” (i ndryshuar)	28923
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 312, datë 12.12.2025	Mbi lënien në fuqi deri më 30 prill 2026 të tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022.....	28923
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 313, datë 12.12.2025	Mbi lënien në fuqi për vitin 2026 të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019.....	28926
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 322, datë 15.12.2025	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2026.....	28927
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 323, datë 15.12.2025	Mbi përcaktimin e listës së tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për vitin 2026.....	28929
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 324, datë 15.12.2025	Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2026.....	28933



URDHËR

Nr. 705, datë 9.12.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, për datat 10.12.2025 dhe 11.12.2025, të zëvendësministrit të Drejtësisë, znj. Elona Hoxha.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Elona Hoxha, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Besfort Lamallari

VENDIM

Nr. 35, datë 11.12.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË
DREJTËSI NR. 4, DATË 13.3.2019, “PËR
PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË
KANDIDATËVE PËR POZICIONET
VAKANTE NË GJYKATËN
KUSHTETUESE DHE TË INSPEKTORIT
TË LARTË TË DREJTËSISË”
(I NDRYSHUAR)**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 229, dhe të pikës 6, të nenit 240, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (i ndryshuar), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

Në vendimin nr. 4, datë 13.3.2019, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” (i ndryshuar) bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 4 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“4. Në ditën e mbledhjes së Këshillit zhvillohet procedura e shortit për caktimin e relatorit/relatorëve, sipas numrit të kandidatëve dhe vëllimit të punës së verifikimit. Si rregull, kandidatët ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet relatorëve të caktuar me short. Çdo relator përgatit projektaktet për kandidatët që i janë caktuar.”.

2. Pika 44 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“44. Këshilli vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Abstenimi nuk lejohet. Në rast barazie votash, vota e Kryetarit është vendimtare.”.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Sokol Sadushi

Anëtarë: Ilir Toska, Marjana Semini, Fuat Vjerdha, Etien Kapo, Enkela Vlora, Genti Xholi, Alma Muça, Nafije Hasko

VENDIM

Nr. 312, datë 12.12.2025

**MBI LËNIEN NË FUQI DERI MË 30
PRILL 2026 TË TARIFAVE TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË MIRATUARA ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 73,
DATË 13.4.2022**

Në mbështetje të neneve 16, 19 dhe 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96,



datë 17.6.2016; “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2363/1 prot., datë 9.12.2025, si dhe informacionin shtesë me nr. 2363/2 prot., datë 9.12.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 288, datë 23.12.2024, ka vendosur të shtyjë fuqinë juridike të vendimit nr. 73, datë 13.4.2022, deri në miratimin e një vendimi të ri, të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “OSSH” sh.a. për vitin 2025, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në konstatimet e vendimit nr. 288/2024, ndër të tjera është përcaktuar dhe detyrimi që shoqëria “OSSH” sh.a. të përcjellë në ERE kostot dhe të ardhurat faktike të shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe të dorëzojë pasqyrat financiare të audituara për periudhat e mbyllura ushtrimore, në përputhje me metodologjinë në fuqi.

- Gjatë vitit 2025, për qëllime të vlerësimit të mjaftueshmërisë së të ardhurave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe në mungesë të një aplikimi të plotë tarifar sipas legjislacionit në fuqi, ERE ka mbajtur një sërë korrespondencash zyrtare për depozitimin e dokumentacionit teknik dhe financiar. Me shkresën nr. 1888 prot., datë 16.6.2025, ERE ka kërkuar dërgimin e pasqyrës së performancës për tremujorin e parë të vitit 2025, pasqyrës *Cash Flow*, nivelit të humbjeve të realizuara në rrjetin e shpërndarjes dhe burimit të mbulimit të tyre, si dhe sasinë e energjisë së shpërndarë, të ndarë sipas niveleve të tensionit, duke i risjellë në vëmendje shoqërisë edhe detyrimin për depozitimin e pasqyrave financiare të audituara për vitet 2022, 2023 dhe 2024.

- Në përgjigje të kësaj kërkesë, “OSSH” sh.a., me korrespondencën nr. 6399/1 prot., datë 27.6.2025, protokolluar në ERE me nr. 1888/1, datë 30.6.2025, ka depozituar në ERE pasqyrën e performancës për tremujorin e parë të vitit 2025, nivelin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe burimin e mbulimit të tyre, evidencën mbi sasinë e energjisë së shpërndarë sipas nivelit të tensionit, si dhe pasqyrat financiare të audituara për vitet 2022 dhe 2023. Lidhur me

pasqyrat financiare për periudhën e mbyllur 2024, shoqëria ka deklaruar se ato janë ende në proces hartimi dhe auditimi, ndërsa sa i takon pasqyrës *Cash Flow* për tremujorin e parë të vitit 2025, është shprehur se do të vihet në dispozicion sapo të përfundojë.

- Me mbylljen e gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, ERE, me shkresën nr. 2097 prot., datë 15.7.2025, ka vlerësuar të nevojshme kërkesën drejtuar “OSSH” sh.a. për dërgimin e pasqyrave financiare operative për periudhën janar–qershor 2025, ku të përfshihet pasqyra e performancës me evidentimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara në formë analitike për secilin zë, pasqyra *Cash Flow*, niveli i humbjeve të realizuara në rrjetin e shpërndarjes dhe burimi i mbulimit të tyre, sasia e energjisë së shpërndarë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, e ndarë sipas niveleve të tensionit, si dhe parashikimi i të ardhurave, shpenzimeve, humbjeve dhe sasisë së energjisë së shpërndarë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025.

- “OSSH” sh.a., në përgjigje të kësaj kërkesë, me anë të postës elektronike të datës 22.7.2025, ka përcjellë në ERE, pasqyrën e performancës për periudhën janar–qershor 2025, nivelin e humbjeve të realizuara në rrjetin e shpërndarjes për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, sasinë e energjisë së shpërndarë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025 të ndarë sipas niveleve të tensionit, parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për mbylljen e vitit 2025, si dhe parashikimin e bilancit energjetik për vitin e plotë 2025.

- ERE, me shkresën me nr. 2363 prot., datë 26.8.2025, i solli në vëmendje shoqërisë “FSHU” sh.a. plotësimin e detyrimit për depozitimin e aplikimit për përcaktimin e tarifës së rrjetit të shpërndarjes për vitin 2026, brenda afateve të përcaktuara në kuadrin ligjor të sipërcituar. Sa paraqitur nga ERE, rezultoi se shoqëria nuk përmbushi detyrimin.

- Më tej, në muajin dhjetor 2025, ERE, me shkresën nr. 2958 prot., datë 3.12.2025, për qëllime të vlerësimit të mjaftueshmërisë së të ardhurave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe në mungesë të një aplikimi sipas legjislacionit në fuqi, i ka kërkuar “OSSH” sh.a. paraqitjen e parashikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve në formë analitike për 11-mujorin dhe mbylljen e vitit 2025, parashikimet që shoqëria ka kryer, në lidhje me treguesit ekonomikë dhe financiarë që pritet të



realizohen për vitin 2026, parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në formë analitike për vitin 2026, parashikimin e nivelit të humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes dhe koston e blerjes së energjisë elektrike dhe burimin e mbulimit të tyre për vitin 2026, si dhe parashikimin e sasisë së energjisë elektrike që pritet të lëvrohet në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2026, të evidentuar sipas niveleve të tensionit.

- Kësaj kërkesë shoqëria “OSSH” sh.a. iu përgjigj me shkresën me nr. 12736/1 prot., datë 10.12.2025 (protokolluar me tonën me nr. 2958/1 prot., datë 10.12.2025) nëpërmjet të cilës përcolli parashikimin e zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2025, parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në forme analitike për vitin 2026, parashikimin sa i takon nivelit të humbjeve të energjisë elektrike për këtë periudhë, koston e blerjes së energjisë dhe burimin për mbulimin e tyre, si dhe parashikimin për sasinë e energjisë që pritet të lëvrohet në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2026 sipas niveleve të tensionit.

- Sa konstatuar në informacionet e përcjella nga shoqëria “OSSH” sh.a. me shkresën e sipërcituar, treguesit tekniko-ekonomik sa i takon parashikimit për vitin 2026 bëhet e nevojshme kryerja e një vlerësimi për arsye se edhe nëse niveli i shpenzimeve operative kanë qenë të qëndrueshëm në kohë, sasia e energjisë që pritet të shpërndahet ashtu edhe niveli i humbjeve kanë ndryshuar dhe vijnë të parashikohen në rritje ndaj atyre të realizuara deri më tani për shkak të rritjes së konsumit.

- Meqenëse këta tregues teknik dhe ekonomik kanë impakt domethënës në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë, bëhet e nevojshme që të kryhet një vlerësim gjithëpërfshirës i elementeve të të ardhurave të kërkuara të cilat si rrjedhojë shërbejnë për përcaktimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë me korrespondencat e sipërcituara (nr. 1888/1, datë 30.6.2025, si dhe *email*-i i datës 22.7.2025), rezulton se për vitin 2024 pasqyrat financiare janë ende në proces hartimi dhe se të dhënat financiare për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, parashikimi për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025 janë paraqitur vetëm në formë sintetike, të pashoqëruara me shënime shpjeguese dhe pa detajim të mjaftueshëm analitik.

- Në këto kushte, konstatohet se informacioni dhe dokumentacioni i depozituar nga “OSSH” sh.a. nuk është i plotë dhe i mjaftueshëm për të kryer një vlerësim të plotë dhe të detajuar të komponentëve faktik të të ardhurave të kërkuara, sikurse përcaktohet në dispozitat e “Metodologjisë së përllogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017, si dhe në kërkesat e “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s.

- Për kryerjen e një vlerësimi të drejtë mbi komponentët e të ardhurave të kërkuara të realizuara, vlerësohet e domosdoshme që “OSSH” sh.a. të miratojë pasqyrat financiare për periudhën e mbyllur ushtrimore 2024, dhe t'i përcjellë në ERE pasqyrat e audituara, së bashku me aplikimin për shqyrtimin e tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike, në përputhje me afatet dhe kërkesat e “Metodologjisë së përllogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”.

- Duke marrë në konsideratë faktin që jemi në përfundim të vitit 2025 dhe koha e mbetur në dispozicion është e pamjaftueshme për kryerjen e një vlerësimi të treguesve teknik dhe ekonomik të parashikuar për vitin 2026, ERE është dhe në proces të shqyrtimit të planit 5-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes, me qëllim që shoqëria të vijojë ushtrimin e aktivitetit të saj për periudhën e ardhshme ushtrimore me tarifa të shpërndarjes së energjisë elektrike të miratuara nga ERE, vlerësojmë të nevojshme që tarifat aktuale të shpërndarjes së energjisë elektrike duhet të aplikohen deri më 30.4.2026.

- Gjatë kësaj periudhe duhet të ketë përfunduar dhe hartimi i pasqyrave financiare të “OSSH” sh.a. ndërkohë që do të dërgohen dhe kërkesat për informacion të nevojshme shoqërisë me qëllim përcjelljen e të dhënave, sqarimeve dhe argumenteve të tjera plotësuese mbi realizimin e treguesve tekniko-ekonomik dhe financiar për periudhat e mbyllura ushtrimore, të cilat do të shërbejnë për kryerjen e vlerësimeve lidhur me parashikimet e tyre për vitin 2026.

- OSSH duhet të marrë masa për përcjelljen në ERE të pasqyrave financiare të certifikuara për vitin



2024 dhe 2025, dhe të plotësojë kërkesat e akteve ligjore dhe rregullatore në fuqi.

- Sipas përcaktimeve të nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave, ERE miraton tarifa të përkohshme dhe në rast se tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, vendos masat e përshtatshme kompensuese.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të lërë në fuqi deri më 30.4.2026 tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërisë “OSSH” sh.a. do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe metodologjisë përkatëse të miratuar nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë “OSSH” sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 313, datë 12.12.2025

MBI LËNIEN NË FUQI PËR VITIN 2026 TË TARIFËS SË PËRKOHSHE TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA “ALBGAZ” SHA, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 206, DATË 16.12.2019

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13, pika 1, 16 pika 2, 17, germa “e” dhe 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 21, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2392/1 prot., datë 10.12.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve dhe Drejtoria e Gazit Natyror “Mbi lëniën në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, ‘Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ‘Albgaz’ sh.a. për vitin 2026”;

konstatoi se:

- Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga “Rregullorja për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016 të Bordit të ERE-s, si dhe nga “Metodologjia për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 178, datë 8.11.2017, ERE i ka kërkuar shoqërisë “Albgaz” sh.a. paraqitjen e një kërkesë për miratimin e tarifave të reja, të shoqëruar me informacionin dhe dokumentacionin përkatës, jo më vonë se gjashtë muaj para hyrjes së tyre në fuqi, përmes shkresës nr. 2362 prot., datë 26.8.2025.

- Në përgjigje të kësaj kërkesë, shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 96/1 prot., datë 1.9.2025, protokolluar pranë ERE-s me nr. 2392 prot., datë 2.9.2025, ka bërë me dije se, në rrethanat në të cilat zhvillon aktivitetin e saj të përditshëm si Operator i Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror, nuk ka pasur zhvillime domethënëse që do të ndiknin drejtpërdrejt në elementet përbërëse të metodologjisë së tarifës së transmetimit dhe, për



rrjedhojë, ka kërkuar që edhe për vitin 2026 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit, e miratuar nga Bordi i ERE-s.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 12.10.2023, ka nisur procedurën për shqyrtimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve të “Albgaz” sh.a., ndërsa me vendimin nr. 277, datë 13.12.2024, ka shtyrë vendimarrjen deri në dhjetor 2025.

- Tarifa e transmetimit të gazit natyror përllëgaritet, ndër të tjera, mbi bazën e investimeve të parashikuara në planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të “Albgaz” sh.a.

- “Albgaz” sh.a., në cilësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, nuk ka paraqitur pranë ERE-s një aplikim për miratimin e një tarife të re transmetimi, sipas legjislacionit dhe metodologjisë në fuqi.

- Në vijim të procedurës, ERE i është drejtuar “Albgaz” sh.a. me shkresën nr. 2852 prot., datë 13.11.2025, për dorëzimin e dokumentacionit plotësues për vijimin e procedurës së miratimit të planit dhjetëvjeçar (2023–2032).

- Me shkresën nr. 119/1 prot., datë 27.11.2025, “Albgaz” sh.a. ka kërkuar shtyrjen e miratimit të planit dhjetëvjeçar deri në dhjetor 2026, duke sqaruar se ndodhet në një fazë të rëndësishme zhvillimi të sistemit të gazit natyror.

- Neni 17, germa “e”, i ligjit nr. 102/2015, parashikon kompetencën e ERE-s për miratimin e tarifave të përkohshme të transmetimit dhe vendosjen e masave kompensuese, në rast vonesash ose diferencash me tarifat përfundimtare.

- Në mungesë të një aplikimi për tarifë të re, dhe duke qenë se tarifa e transmetimit është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit dhe garantimin e aksesit në rrjet, vlerësohet e nevojshme shtyrja e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, edhe për vitin 2026, deri në miratimin e një tarife të re sipas legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi për vitin 2026 të tarifës së transmetimit të gazit natyror miratuar me vendimin nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “Albgaz” sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit

17, pika “e”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 322, datë 15.12.2025

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE ME PAKICË PËR KLIENTËT FUNDORË QË SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR VITIN 2026

Në mbështetje të neneve 16, 19, 20, germa “c”, 21 dhe nenit 83 dhe 85 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; neneve 15 dhe 22 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të



datës 15.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2957/2 prot., datë 12.12.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi çmimin e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e shërbimit universal për periudhën 1 shkurt–1 dhjetor 2025”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 10, datë 8.1.2025, ka përcaktuar çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 shkurt 2025–31 dhjetor 2025.

- Me vendimin nr. 255, datë 15.10.2025, Bordi i ERE-s ka përcaktuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kw, të lidhura në nivelin e tensionit 0.4 kV.

- Në përfundim të 3-mujorit të parë të vitit 2025, ERE, me shkresën me nr. 1876 prot., datë 13.6.2025, vlerësoi të nevojshme t'i drejtohej FSHU sh.a., duke i kërkuar informacion në lidhje me pasqyrat financiare operative të tremujorit të parë të vitit 2025, pasqyrën e *Cash Flow* për tremujorin e parë të vitit 2025, si dhe sasinë e energjisë të furnizuar për klientët përfitues nga shërbimi i furnizimit të mundësisë së fundit, të kategorizuar sipas niveleve të tensionit që janë lidhur këto klientë dhe çmimet mesatare të realizuara për secilën kategori; si dhe kërkoi dërgimin në ERE të pasqyrave financiare të audituara të shoqëruara me shënimet shpjeguese për periudhat ushtrimore të mbyllura 2023–2024.

- FSHU sh.a., me anë të shkresës me nr. 1876/1 prot., datë 24.6.2025, depozitoi në ERE pasqyrën e performancës për periudhën janar–mars 2025, sasinë e energjisë për 5-mujorin e parë të vitit 2025, të ndarë sipas niveleve të tensionit dhe çmimit, si dhe pasqyrat financiare të plota dhe të audituara të shoqëruara me shënimet shpjeguese për periudhën e mbyllur ushtrimore 2023.

- Me përfundimin e gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, ERE i është drejtuar sërish shoqërisë FSHU sh.a. me shkresën nr. 2098 prot., datë 15.7.2025, duke i kërkuar dërgimin e të dhënave në lidhje me pasqyrat financiare operative të gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, pasqyrën e *Cash Flow*, sasinë e energjisë së furnizuar për klientët që janë shërbyer në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit, si dhe furnizimit universal përgjatë 6-mujorit të parë të vitit

2025, si dhe parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën e mbetur të vitit 2025.

- Në përgjigje të kërkesës së mësipërme FSHU sh.a., me anë të shkresës me nr. 2098/1 prot., datë 6.0.2025, përcolli treguesit ekonomikë dhe financiar të realizuar për 6-mujorin e parë të vitit 2025, si dhe pritshmëritë e saj për pjesën e mbetur të vitit.

- Me anë të shkresës me nr. 2363 prot., datë 26.8.2025, ERE i solli në vëmendje shoqërisë përmbushjen e detyrimeve mbi paraqitjen pranë ERE të kërkesës për rishikimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike me pakicë për klientët që furnizohen nga FSHU sh.a., për vitin 2026, brenda afateve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.

- ERE, me shkresën me nr. 2957 prot., datë 3.12.2025, me qëllim kryerjen e vlerësimit lidhur me mjaftueshmërinë e të ardhurave të FSHU sh.a. për vitin 2026 dhe në mungesë të një aplikimi sipas legjislacionit në fuqi, shoqërisë FSHU sh.a. iu kërkuar informacioni në lidhje me parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në formë analitike për 11-mujorin dhe mbylljen e vitit 2025, parashikimet që FSHU sh.a. ka kryer në lidhje me treguesit ekonomikë dhe financiarë për vitin 2026, parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në formë analitike për vitin 2026, koston e blerjes së energjisë elektrike për klientët e furnizuar në kushtet e shërbimit universal për vitin 2026, parashikimin e sasisë së energjisë elektrike që pritet të shitet nga FSHU sh.a. si dhe parashikimet lidhur me strukturën e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike, që priten të aplikohen për klientët e furnizuar në kushtet e shërbimit universal për vitin 2026.

- Në përgjigje të sa më sipër, FSHU sh.a., me shkresën me nr. 6391/1 prot., datë 9.12.2025, (protokolluar me tonën me nr. 2957/1 prot., datë 10.12.2025) përcolli në ERE informacionin lidhur me parashikimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve për mbylljen e vitit 2025, si dhe parashikimet për këta tregues për vitin 2026; koston e parashikuar të blerjes së energjisë elektrike për klientët e furnizuar në kushtet e shërbimit universal për vitin 2026 dhe sasinë e energjisë elektrike, si dhe çmimet respektive, sipas kategorive të klientëve që furnizohen në kushtet e shërbimit universal;

- Bazuar në të dhënat e deklaruara nga shoqëria, rezulton se çmimet e miratuara me vendimet nr. 10, datë 8.1.2025, dhe vendimin nr. 255, datë 15.10.2025, gjenerojnë të ardhura të cilat kanë mbuluar kostot e aktivitetit të shoqërisë, duke



garantuar ushtrimin e një aktiviteti normal operacional, aktiviteti i cili pritet të vijojë në të njëjtën formë dhe për vitin 2026.

- Në mënyrë që shoqëria FSHU sh.a., edhe për vitin 2026, të mundet të realizojë aktivitetin për të cilin është licencuar, bëhet e domosdoshme të vijojë faturimin, bazuar në çmimet e miratuara nga ERE.

- Bordi i ERE-s, me vendimit nr. 312, datë 12.12.2025, vendosi ndër të tjera të lërë në fuqi deri më 30.4.2026, tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, periudhë në të cilën do të kryhet vlerësimi i elementeve të të ardhurave të kërkuara të aktivitetit të OSSH sh.a., të cilat shërbejnë për përcaktimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Shoqëria FSHU sh.a. duhet të përcjellë në ERE kostot dhe të ardhurat faktike të aktivitetit të furnizimit të shërbimit universal të energjisë elektrike për vitet 2024 dhe 2025, si dhe të marrë masa në plotësimin e kërkesave dhe të dispozitave të akteve ligjore dhe rregullatore në fuqi, të cilësuar si më lart.

- Për sa më sipër, vlerësohet e nevojshme shtyrja e fuqisë juridike të vendimit nr. 10, datë 8.1.2025 deri më 31.12.2026, si dhe shtyrja e fuqisë juridike të vendimit nr. 255, datë 15.10.2025 deri më 31.12.2026, deri në momentin e paraqitjes nga shoqëria të kërkesës për rivlerësim të kostove.

- Nëse mbas kryerjes së vlerësimit të elementeve të të ardhurave të kërkuara të OSSH sh.a. do të rivlerësohen tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, ERE do të kryej transferimin e kostove të shpërndarjes së energjisë elektrike te çmimet e shitjes me pakicë të klientëve fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 10, datë 8.1.2025 deri më 31.12.2026, për çmimet me pakicë për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal.

2. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025 deri më 31.12.2026, për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në

pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kw të lidhura në nivelin e tensionit 04 kV.

3. Mbas kryerjes së vlerësimit të elementeve të të ardhurave të kërkuara të OSSH sh.a., ERE do të kryej transferimin e kostove të shpërndarjes së energjisë elektrike te çmimet e shitjes me pakicë të klientëve fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, si dhe korrigjimin e kompensimin e tyre, në përputhje me përcaktimet e nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe metodologjive përkatëse, të miratuara nga ERE.

4. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë FSHU sh.a., si dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 323, datë 15.12.2025

MBI PËRCAKTIMIN E LISTËS SË TARIFAVE TË OPERATORIT TË EMËRUAR TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO) PËR VITIN 2026

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 286, datë 20.12.2024; si dhe të neneve 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin e



përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve me nr. 2704/10 prot., datë 12.12.2025, “Mbi përcaktimin e listës së tarifave të operatorit të tregut të energjisë elektrike (NEMO) për vitin 2026”,

konstatoi se:

I. Aspektet ligjore dhe procedurale

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 307, datë 21.11.2025, vendosi “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ALPEX sh.a. për përcaktimin e tarifave të NEMO-s për vitin 2026”.

- Në vijim të këtij vendimi, ERE i është drejtuar shoqërisë ALPEX sh.a. me shkresën nr. 2704/3 prot., datë 21.11.2025, me anë të së cilës kërkon sqarime të mëtejshme, në lidhje me: ndarjen e llogarive sipas aktivitetit të shfrytëzimit (ALPEX dhe NEMO); stadin aktual të investimeve sa i takojnë aktivitetit të NEMO-s; vlerësimet në lidhje me kostot e realizuara faktike të aktivitetit të NEMO-s për vitin 2025 (si vit testimi).

- Shoqëria AlpeX sh.a. ka përcjellë në ERE shkresën me nr. 413/4 prot., datë 3.12.2025, protokolluar në ERE me nr. 2704/6 prot., datë 3.12.2025, me anë të së cilës shoqëria sqaron mbi informacionet e kërkuara, përfshirë: paraqitjen në formë tabelare të kostove operacionale të aktivitetit për vitet 2026, 2027 dhe 2028 të ndara për kompaninë mëmë (zyra qendrore e ALPEX Shqipëri) dhe degën në Kosovë; informacion mbi investimet e planifikuara për vitin 2025 dhe gjendjen e tyre; si dhe llogaritë e shpenzimeve për nëntëmujorin e vitit 2025 për zyrën qendrore dhe për degën Kosovë.

- Në vijim të kësaj përgjigje shoqëria ALPEX sh.a. ka paraqitur në ERE versionin e rishikuar të kërkesës për përcaktimin e tarifave të NEMO për vitet 2026, 2027, 2028 me anë të shkresës me nr. 413/5 prot., datë 3.12.2025, protokolluar në ERE me nr. 2704/7 prot., datë 3.12.2025, ku shoqëria ka rishikuar parashikimet për vitet 2026, 2027 dhe 2028 në të ardhurat, shpenzimet, humbjet etj.

- Bazuar në urdhrin nr. 148, datë 21.11.2025, ERE njoftoi shoqërinë ALPEX sh.a. mbi zhvillimin e seancës dëgjimore teknike ndërmjet përfaqësuesve të ERE-s dhe ALPEX-it, në datën 5.12.2025 dhe në zbatim të urdhrin të sipërcituar u zhvillua seanca dëgjimore teknike, ku u diskutua mbi aplikimin e përcjellë nga shoqëria ALPEX sh.a., si dhe mbi kërkesat e ERE-s.

- Duke qenë se disa nga çështjet e diskutuara nuk morën përgjigje as nëpërmjet shkresës të përcjellë në

ERE me nr. 413/4 prot., datë 3.12.2025, protokolluar në ERE me nr. 2704/6 prot., datë 3.12.2025 dhe as gjatë seancës dëgjimore teknike, ERE i është drejtuar përsëri shoqërisë ALPEX sh.a. kërkesë me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 2403/16 prot., në të cilin ka kërkuar sqarime përsëri, mbi: ndarjen e llogarive; investimet dhe planin e investimeve; RAB; vlerësimet e shoqërisë sa i takon normës së realizimit faktik të kostove operative dhe kapitale ndaj parashikimeve që nga koha e emërimit si NEMO.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria ALPEX sh.a. i është drejtuar ERE-s me *e-mail* të protokolluar në ERE me nr. 2403/17, datë 10.12.2025, me anë të të cilit bën me dije se është në proces të zbatimit të ndarjes së llogarive dhe kostove, sipas secilit aktivitet. Gjithashtu, shoqëria shprehet se aktivitetet e realizuara për proceset e NEMO-s dhe operatorit të tregut kanë qenë të kufizuara.

II. Vlerësimi ekonomik dhe teknik i kërkesës

- Duke iu referuar kërkesës së përcjellë nga shoqëria ALPEX sh.a., konstatohet se shoqëria nuk ka përcjellë ndarje të llogarive sipas aktivitetit të shfrytëzimit NEMO dhe ALPEX konform nenit 6 të “Metodologjisë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, ku përcaktohet se NEMO, si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike, duhet të mbajë llogari të ndara dhe të qarta financiare nga kompania mëmë ose çdo njësi tjetër e lidhur me të.

- Në aplikimin e përcjellë së fundmi nga shoqëria konstatohet se janë kryer llogaritjet konform metodologjisë përkatëse, duke aplikuar formulat e përcaktuara në këtë metodologji. Nga sa konstatohet të ardhurat e kërkuara të llogaritura nga ALPEX sh.a. sipas të dhënave të paraqitura së fundmi në shkresën e sipërcituar, rikuperohen nëpërmjet tarifave të përcjella në kërkesën e shoqërisë.

- Referuar *e-mail*-it të datës 10.12.2025 ALPEX sh.a. deklaron se konform metodologjisë respektive aktualisht është në proces të zbatimit të ndarjes së llogarive të zërave për secilin aktivitet, por për shkak të operacioneve të kufizuara, si NEMO, pasi aktiviteti i saj primar për periudhën 2025 është ai i bursës së energjisë, të cilin e ushtron si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, por të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara nga NEMO për këtë periudhë ushtrimore nuk kanë qenë të konsiderueshme.



- Referuar të dhënave financiare të paraqitura nga ALPEX sh.a., rezulton se të ardhurat e gjeneruara nga aplikimi i tarifave të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 299, datë 30.12.2024, kanë garantuar ushtrimin e një aktiviteti të qëndrueshëm operacional.

- Në rrethanat ku operacionet e NEMO-s janë të kufizuara dhe aktiviteti i saj si bursë ka qenë më i madh, shoqëria ka propozuar që tarifat që aplikon për funksionin e saj si bursë, të zbatohen, gjithashtu, edhe për aktivitetin e saj si NEMO.

- Meqenëse për periudhën në vijim (2026) mbështetur në deklaratimet e shoqërisë, pritët që aktiviteti i NEMO-s të rritet, ndarja e llogarive do të jetë më e identifikueshme për sa u përket shpenzimeve dhe të ardhurave të aktivitetit të NEMO-s.

- Referuar gjithë sa më sipër, duke qenë se shoqëria nuk ka kryer ndarje të llogarive të aktivitetit të shfrytëzimit ALPEX dhe NEMO, vlerësojmë të gjitha elementet e formulës duhet të bazohen në identifikimin dhe alokimin specifik të shpenzimeve operative dhe kapitale që i përkasin vetëm aktivitetit të NEMO-s, konform shtojcës I të metodologjisë.

- Nëpërmjet kërkesës së përcjellë në ERE, shoqëria ALPEX sh.a. deklaron se aktualisht nuk ka një plan të investimeve. Çdo investim i ardhshëm duhet të paraqitet në përputhje me “Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, dhe të argumentohet përmes analizës së kostove dhe përfitimeve bazuar në pikën 7.5 të shtojcës II të metodologjisë.

- Duke qenë se ndarja e llogarive të aktivitetit të shfrytëzimit të NEMO-s është kusht i domosdoshëm për vijimin e këtij procesi, nuk mundësohet kryerja e vlerësimeve dhe e analizave të kostove të realizuara, por edhe të parashikuara, si dhe treguesve ekonomikë dhe financiarë.

- Shoqëria ALPEX sh.a. duhet të kryejë ndarjen e llogarive sipas aktivitetit të shfrytëzimit ALPEX dhe NEMO dhe të paraqesë në ERE aplikimin sa i takon vetëm aktivitetit si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) konform “Metodologjisë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”.

- Me vendimin nr. 293, datë 13.11.2025, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.4.2025”, është shtyrë data e hyrjes në fuqi të

“Rregullores së Alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimit të kongjestioneve (CACM)” deri më 1 korrik 2026, duke bërë që, deri në fund të vitit 2026, ALPEX sh.a. të vijojë ushtrimin e funksioneve të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) mbi bazën e kuadrit ekzistues rregullator.

- Në këtë kuadër bëhet e nevojshme, që NEMO të vazhdojë të ushtrojë aktivitetin e saj me tarifat e miratuara nga ERE, me vendimin nr. 299, datë 30.12.2024, të Bordit të ERE-s edhe për vitin 2026, deri në momentin e përzgjedhjes së Operatorit të ri të Emëruar të Tregut të energjisë, kohë gjatë së cilës do të shërbejë dhe për identifikimin dhe ndarjen e llogarive për të ardhurat dhe kostot respektive, të cilat do të shërbejnë për krijimin e historikut, sa i takon evidencave të treguesve ekonomikë dhe financiar të aktivitetit operacional të NEMO-s, në zbatim të përcaktimeve të metodologjisë respektive dhe legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit nr. 299, datë 30.12.2024, të Bordit të ERE-s, duke vijuar zbatimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për vitin 2026, sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar, do të bëhet korrigjimi dhe kompensimi përkatës në momentin që shoqëria do të paraqesë një aplikim konform “Metodologjisë për përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 286, datë 20.12.2024.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë ALPEX sh.a., Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) të Kosovës, si dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,



brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

Tabela 1. Lista e tarifave të ALPEX-it, të cilat do të jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), për Tregun e Ditës në Avancë dhe Tregun e Ditës së Njëjtë, për vitin 2026.

Lista e Tarifave të ALPEX	Pagesa e Tarifës	Referenca në monedhën Euro	Paguhet nga
Tarifa Administrative	Një herë	200 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	Vjetore	10,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun e Ditës në Avancë	Vjetore	14,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	7,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	Vjetore	3,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh për Tregun e Ditës në Avancë	Ditore	0.09 €/MWh	Anëtari i Klerimit
Tarifa Teknike	Vjetore	2,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	6,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh	Transaksion	0.02 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Tregtimit në emër të dikujt tjetër	Urdhërporosi	20 €	Anëtari i Bursës
Tarifa për API përdorues	Vjetore	2,000 €	Anëtari i Bursës
Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin personal të Klerimit	Mujore	100 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa e Administrimit të Letër Garancisë Bankare	Kur depozitohet	50 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore e Trajnimit	Vjetore	200 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Tarifa e Provimit	Vjetore	100 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Certifikata digjitale për Përdorues	Vjetore	50 €	Anëtari i Bursës/Anëtari i
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Vjetore	8,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.14 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.04 €	Anëtari i Bursës

- Për tregun e Shqipërisë, të gjitha tarifat do të shlyhen në monedhën euro për jorezidentët.

- Për tregun e Shqipërisë, të gjitha tarifat fikse do të shlyhen në monedhën lekë, ekuivalent të referencës së përcaktuar në monedhën euro, për rezidentët.

- Mbi tarifat do të aplikohet TVSH-ja.

**VENDIM****Nr. 324, datë 15.12.2025****MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE,
QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE
EKZISTUES ME PËRPARËSI
PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 10 dhe 31 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 687, datë 22.11.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i ndryshuar me VKM-në nr. 67, datë 8.02.2023; neneve 15, 21 dhe 22 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme me nr. 3046 prot., datë 12.12.2025, “Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2026”,

konstatoi se:

- Në mbështetje të nenit 10 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike.

- Pika 4 e nenit 10 të ligjit nr. 24/2023 përcakton, se: “për prodhues ekzistues me përparësi, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 15 mw caktohet nga ERE, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, duke u bazuar në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, plus një bonus të caktuar për promovimin e këtyre burimeve, i cili merr në konsideratë një kthim të arsyeshëm të vlerës së investimeve dhe, në çdo rast, ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE-ja në vitin 2016”.

- Në zbatim të nenit 31, pika 2, të ligjit nr. 24/2023, aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe të zbatohen deri në momentin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 24/2023.

- Në këto kushte, përcaktimi i çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 15 mw vijon të kryhet bazuar në përcaktimet e VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i ndryshuar, deri në miratimin e një metodologjie të ndryshme nga Këshilli i Ministrave.

- Me VKM-në nr. 67, datë 8.2.2023, është miratuar një ndryshim në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, ku në pikën 2 të vendimit nr. 687, datë 22.11.2017, shkronja “d” ndryshohet si vijon: “Niveli maksimal i çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike, në çdo rast nuk do të jetë më i lartë se çmimi 10 lekë/kwh (pa TVSH)”.

- Sipas metodologjisë në fuqi, formula për llogaritjen e çmimit vjetor të blerjes paraqitet: “Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kwh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kwh x bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.2 x normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit”.

- Në zbatim të metodologjisë, me normë mesatare të këmbimit të vitit të fundit kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2025, dhe nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë, kursi mesatar i këmbimit për periudhën 10-mujore të vitit 2025 rezulton 98.05 lekë/euro.

- Nga të dhënat paraprake të publikuara nga bursa hungareze e energjisë (HUPX), çmimi i deritanishëm mesatar për periudhën 10-mujore të tregut të ditës në avancë për vitin 2025 rezulton 106.55 euro/mwh dhe çmimi vjetor i blerjes, bazuar në formulën e metodologjisë në fuqi, rezulton 12.53 lekë/kwh.



- Në kuptim të ligjit nr. 24/2023, i cili parashikon se kriteret e llogaritjes së çmimit do të bazohen në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike, për referencë paraqiten edhe të dhënat e çmimit mesatar klerues të bursës shqiptare të energjisë ALPEX, ku për periudhën 10-mujore të vitit 2025 rezulton 118.93 euro/mwh, dhe çmimi vjetor i blerjes, referuar tregut shqiptar dhe në zbatim të formulës së përdorur në metodologjinë në fuqi, rezulton 13.99 lekë/kwh.

- Të dyja vlerat e llogaritura rezultojnë mbi nivelin maksimal prej 10 lekësh/kwh (pa TVSH), të përcaktuar në shkronjën “d” të pikës 2 të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, të ndryshuar me VKM-në nr. 67, datë 8.2.2023.

- Bazuar në llogaritjet e kryera sipas përcaktimeve të metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, miratuar me VKM-në nr. 687, datë 22.11.2017, të ndryshuar, si dhe nivelit maksimal të çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike të përcaktuar në germën “d” të saj, çmimi i blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2026 duhet të jetë 10 lekë/kwh (pa TVSH).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, prej 10 lekë/kwh, për vitin 2026.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë të njoftojë të palët e interesit, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë